



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



Prishtinë, më 15.5.2026

FTESË PËR APLIKIM

Ftesë për aplikim për anëtarë të Komisionit vlerësues për projektet e OJQ-ve në fushën e shërbimeve sociale, ofrimin e mbështetjes financiare publike për projektet/programet e OJQ-ve: që ofrojnë shërbime sociale dhe familjare për individët, familjet dhe grupet e cenueshme, e në nevojë, në Kryeqytetin e Kosovës, Prishtinë.

Bazuar në Rregulloren e Ministrisë së Financave, nr. 04/2017, mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, në nenin 8, paragrafin 3.2, parashihet që pjesë e çdo Komisioni vlerësues për vlerësimin e projektpropozimeve të OJQ-ve të pranuar sipas Thirrjes publike, duhet të jenë dy përfaqësues nga grupi i ekspertëve të jashtëm, duke përfshirë një përfaqësues të OJQ-ve.

Për këtë qëllim, Drejtoria e Mirëqenies Sociale (DMS-ja) fton të gjithë të interesuarit që të aplikojnë për të qenë pjesë në cilësinë e anëtarit të Komisionit vlerësues, për të vlerësuar projektpropozimet e dorëzuara nga OJQ-të, sipas thirrjes publike në fushën e Shërbimeve Sociale, fushëveprimi i të cilave është i fokusuar Fëmijët /pa përkujdesje prindërore e familjare, në rrezik për humbjen e përkujdesit prindëror; Fëmijë të keqtrajtuar, fëmijë dhe të rritur në situatë rruge, të bullizuar (ngacmuar)/stigmatizuar, dhunën në mes bashkëmoshatarëve, të rrezikuar dhe viktimat e krimit kibernetik; Të gjitha grupimet e personave (fëmijë, të rritur) me aftësi të kufizuara; Viktimat e krimit, dhunës në familje, trafikimi i qenieve njerëzore dhe krimeve seksuale; Të mbijetuarat e dhunës në familje – ri integrimi dhe fuqizimi Prindërit vet ushqyese në gjendje të nevojës sociale; Vajzat dhe gratë e marginalizuara në aspektin ekonomik dhe social në viset rurale dhe urbane; Fëmijë në forma të rënda të punës; Fëmijët me sjellje asociale dhe delikuentet e mitur; Të moshuarit në nevojë për përkujdesje familjare e sociale; Të miturit në martesat e hershme vajzave dhe djemve – parandalimi dhe

vetëdijesimi; Komunitetet jo shumicë me përkatësi etnike fuqizimi i kujdesit familjar dhe përfshirja sociale; Fëmijët me nevoja te veçanta edukative- arsimore – nevoja logopedike; Komuniteti LGBTI+ në nevojë për përkrahje me shërbime profesionale e sociale; Abuzuesit e substancave psiko-aktive; Familjet në kushte të pafavorshme socio-ekonomike; Fëmijet dhe të miturit pa përkujdesje dhe të pa shoqëruar – emigrantë; Veteranet dhe invalidët e luftës të datës 14.5.2026, të publikuar nga DMS-ja.

Të gjithë kandidatët të cilët nuk janë nën hetime, apo me precedent penal dhe që kanë përvojë në shoqëri civile, me përparësi nga OJQ-të që merren me fushën e shërbimeve sociale, që ofrojnë shërbime direkte për grupet e ndryshme të cenueshme dhe në nevojë, për ofrimin e mbështetjes financiare publike për financimin e projekteve/programeve të OJQ-ve: që kontribuojnë në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve; ofruesve të shërbimeve sociale, ofruesve të shërbimeve për personat me aftësi të kufizuara, fuqizim të rinjve dhe grave, që ofrojnë të mira materiale për familjet skamnore etj, iu mundësohet të aplikojnë për pjesëmarrje në Komisionin vlerësues, në cilësi të:

- Një përfaqësuesi nga OJQ-të dhe
- Një përfaqësuesi në cilësinë e ekspertit të jashtëm.

Kandidatët duhet t'i dorëzojnë këto dokumente:

- Letërmotivimi;
- CV të përditësuar;
- Kualifikimi.

Aplikimi është nga data 15.5.2026 deri më 22.5.2026.

Aplikimin mund ta bëni duke dorëzuar një kopje fizike të dokumentacionit të kërkuar në:
Komuna e Prishtinës, Drejtoria e Mirëqenies Sociale, rr. UCK, nr. 2, 10000, Prishtinë, Qendra për shërbime me qytetarë, kati I, sporteli nr.3.

DMS-ja do të vlerësojë të gjitha aplikacionet e pranuar dhe kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret e përcaktuara përmes kësaj ftese publike, do të jenë pjesë e Komisionit vlerësues të thirrjes publike në fushën e shërbimeve sociale, të datës 14.5.2026, të publikuar nga DMS-ja.